



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

OFERTË TEKNIKO - TREGTARE PËR
OFRIMIN E OBJEKTEVE TË LIRA MINERARE
DHE PËRPUNUESE TË INDUSTRIË TË
BAKRIT, PËR SHFRYTËZIM, ZHVILLIM DHE
ADMINISTRIM AFAT GJATË

Maj 2017

Pergatitur nga Grupi i punës :

-1- Gëzim Musabelliu,	Z/Ministër,	Kryetar
-2- Mehmet Hasalami,	Drejtore i Politikave dhe Zhvill.Minierave,	Anëtar
-3- Arben Dhima,	Drejtore i Politikave, Zhvill.Industrise dhe Stand.Tek .	Anëtar
-4- Kujtim Gjoka,	Përgj.Sektore i Lejeve Minerare	Anëtar
-5- Fatos Manastirliu	Përgj. Sektore i Politikave dhe Zhvill. Minierave	Anëtar
-6- Nikollë Gega	Përgj.Sektore i Politikave dhe Zhvill. Industrisë	Anëtar
-7- Vasil Pano,	Specialist në Drejtorine e Koncesionave dhe Privatiz.	Anëtar
-8- Edmond Goskolli,	Këshilltar i Drejtorit Ekzekutiv në AKBN	Anëtar
-9- Nikollë Kaza,	Drejtore i Burimeve Minerare në SHGJSH,	Anëtar

Tiranë Maj 2017.

Përmbajtja

- I- Te dhëna per objektin kryesor te ofertes

- Qëllimi

-1- Historik i shkurtër i industrisë se bakrit ne Shqiperi

-2- Situata aktuale e kësaj industrie

-3- Te dhëna per rezervat minerare te bakrit sipas vendburimeve dhe pritshmëria per te ardhmen, se paku periudhe 10 vjeçare.

-4- Te dhëna per objekte përpunuese te industrisë se bakrit

-5-Te dhëna per lenden e pare koncentrate bakri nga operator ne kete industri, mundësia nga objektet e lira, mbetjet metalike te bakrit e lidhjeve te tij bronz e tunxh qe sot eksportohen

-6- Te dhëna per vlerën e përafërt te investimit sipas sektorëve, miniera, pasurim dhe metalurgji deri tela e kablllo e vlerësim pike ekuilibri per prodhimin optimal, e jetëgjatësi projekti.

-7- Te dhëna per nevojat e tregut vendas per produkte prej bakri dhe lidhjeve te tij si tela dhe kablllo prej bakri, tuba, rekorderi etj

-8-Pozicioni i Shqiperise ne tregun rajonal per burime bakri dhe produkte te tij

-9- Kuadri ligjor rregullator qe mundëson nxitjen e biznesit dhe sipërmarrjes ne kete industri

-10- Lehtesira te mundeshme per investime ne kete industri

-11- Te dhëna per marredhenet e pronësisë se tokës, burimet e furnizimit me energji elektrike, uje, etj

-12- *Problemet mjedisore*, kerkesa per mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës

-13- Te dhëna per kuadrin rregullator per licensimet dhe taksat, rregullimin e territorit etj

-14- Te dhëna per ekonominë, kulturën, etj per mjedisiin ne zonat ku parashikohet ky zhvillim

II- Kerkesa specifike per ofertuesin

-1- Eksperienca ne menaxhim te fushës se industrisë minerare dhe përpunuese

-2- **Mundesia per financime**

-3- Kerkesa te tjera

OFERTE TEKNIKO-TREGTARE

Per ofrimin e disa objekteve minerare dhe përpunuese ne industrinë e bakrit, per shfrytëzim, administrim dhe zhvillim ne përputhje me kuadrin ligjor

Qellimi: Promovim, **nxitje** dhe mbështetje e biznesit për te mundësuar rritjen e shkallës se përpunimit te bakrit dhe elementeve te tjerë bashkëshoqërues, referuar resurseve aktuale dhe atyre perspektive, si nje instrument qe ndikon ne maksimizimin e vlerave te kësaj pasurie ne dobi te ekonomisë se vendit, me rritje e te ardhurave ne buxhet, eksport, zbutje e problemeve sociale ne zonat poseduese te kesaj pasurie me nivel punësimi etj.

-1-Historik i shkurtër per industrinë e bakrit ne Shqiperi

Industria e bakrit është nga industritë më të vjetra të vendit tonë. Ajo ka funksionuar komplekse duke filluar nga kërkimet gjeologjike, nxjerrjen e mineralit, pasurimin, prodhimin e bakrit blister, elektrolitik, telave e kablllove, tunxheve dhe lidhjeve të tjera të bakrit, petëzimi tunxhi e deri në përpunimin e skorieve. Zanafilla e saj fillon nga vitet 1936, me kërkime gjeologjike të kryera nga italianet dhe më vonë me fillimin e prodhimit të mineralit në minierën e Rubikut shoqëruar me ndërtimin e fabrikës se pasurimit dhe të uzinës se shkrirjes. Mbas luftës II botërore, me bazë minierën dhe uzinën e Rubikut kjo industri u riaktivizua në vitin 1946. Ritmet e prodhimit u rriten nga viti në vit dhe në vitin 1960 u prodhuan 72200 ton mineral dhe 950 ton bakër blister i cili eksportohej.

Pas kësaj periudhe zhvillimi i industrisë se bakrit u bë në dy drejtime, intensive dhe ekstensive, ku prioritet më të madh iu dha rrugës së dytë. Kështu u vunë në shfrytëzim shumë miniera, **u ndërtuan 7 fabrika pasurimi, 3 uzina bakri dhe uzina e telave dhe kablllove në Shkodër**. Me këto investime u mbyll plotësisht në vend cikli i përpunimit të plotë të mineralit të bakrit (nga nxjerrja deri në prodhimin e telave dhe kablllove që mbulonin nevojat e vendit dhe për eksport). Pas vitit 1985 përparësi mori shfrytëzimi intensiv i industrisë së bakrit. Nivelet me të larta të prodhimit u arritën në vitin 1989, ku u prodhuan 1.14 milion ton mineral bakri, 62,000 ton koncentre bakri, koncentre piriti, dhe 15,300 ton bakër blister. Pas viteve 1990, me ndryshimin e sistemit, me skemën e organizimit ne nivel korporate të bakrit (Albbakër), bazuar ne ndihmën ekonomike të dhënë nga qeveria dhe Komuniteti Evropian, filloi stabilizimi i pjesës së industrisë që kishte mbetur pa u dëmtuar ose që mundi të rivihej në punë me shpenzime jo të mëdha e cila ishte vlerësuar si ekonomike për shfrytëzim. Në vitet 1995-1997, u riaktivizua kjo industri në 13 ndërmarrje me 4,500 punonjës, u vunë në funksionim 15 miniera të organizuara në 7 ndërmarrje minerare, 7 fabrikat e pasurimit, 3 uzinat e bakrit dhe uzina e telave.

Ballafaqimi me ekonominë e tregut bëri të domosdoshëm rivlerësimin ekonomik të kësaj industrie pothuajse për çdo vendburim, kështu u konservuan dhe u mbyllën disa vendburime minerare, fabrika pasurimi dhe uzina e bakrit Kukës, mbajtja në punë e të cilave rëndonte së tepërmi gjendjen ekonomike të kësaj dege. Pas ngjarjeve të vitit 1997 kjo industri u pezullua plotësisht.

Megjithatë disa përpjekje për riaktivizimin e saj, rënia e ndjeshme e çmimit të metalit të bakrit në tregun botëror, konsumi i madh i rezervave, mungesa e investimeve e faktorë të tjerë objektive dhe subjektive, bënë që këto përpjekje të dështonin. Përfundimisht, ***me vendim Qeverie, mbështetur në analizat ekonomiko-financiare, u mbyllën, konservuan dhe më vonë u demontuan një sërë objektesh të kësaj industrie***. Ne vitin 2001 është realizuar dhënia me koncension e disa objekteve kryesore te kësaj industrie, e Si rrjedhoje ne vitin 2004 e vazhdim rifilloi aktivizimi i saj por vetëm deri ne pasurim.

-2- Situata aktuale e kësaj industrie

Objektet e industrisë së bakrit në vitin 2001 janë dhënë me koncesion një kompanie turke “BER-ONER” me shoqëri koncesionare “Ber Alb” shpk.

Kjo industri në periudhën 2004 deri 2015 ka funksionuar e lokalizuar në shfrytëzimin e dy minierave Munelle dhe Lak Rosh në rajonin e Pukës, duke e pasuruar mineralin e pasur në Fabrikën e Pasurimit në Fush-Arrez.

Miniera polimetalore e Munelles ka patur një shpërndarje mineralogjike të tillë ku një trup prej rreth 1 milion ton mineral ka patur cilësi shumë të larta : bakri mesatar 4 – 5 %, zinku mesatar 3 % dhe ari 4 gr/ton, argjendi 65 gr/ton krahas elementeve të tjerë si Selen, Stibium etj.

Njekohesisht disa kompani shumica kanadeze kanë patur leje minerare për kërkim-zbulim të cilat, realisht me tepër janë fokusuar në rivlerësimin e rezervave të zbuluara më parë nga institucionet shqiptare deri në vitin 1992, duke mos kontribuar në shtimin e rezervave të reja.

Nga skema e përpunimit të plote e trashëguar deri në vitin 1990, pjesërisht ka funksionuar vetëm Uzina e Telave në Shkodër. Fabrika e Shkërjes në ish Uzinen e Bakrit në Rubik është demoluar në vitin 2007 – 2008, ndërsa Uzina e Rafinimit i ishte dhënë me koncesion një subjekti në fund të vitit 2012 por që tashmë ka dështuar që në vitin e parë sepse ideja koncesionari kerkonte përshtatjen e saj për prodhim ferrokromi.

Në fundin e vitit 2015 edhe kompania turke “BER-ONER” e fokusuar në rajonin e Pukës me skemë prodhimi deri në koncentrat bakri, ka ndërprerë prodhimin duke u justifikuar me rënien e çmimit të metaleve në bursë që realisht vihet re por më së shpejti jo shumë e argumentuar pjesa që lidhet me ndalimin e plote të punës.

-3- Te dhëna per rezervat minerare sipas vendburimeve

3.1- Rezervat e bakrit sipas Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (viti 2016)

Nr.	Vendburimi/Objekti	Rezerva gjeologjike	Permbajtja e bakrit (Cu)%.
1	Spaç	4668800	1.236
2	Gurth-1	97061	2.71
3	Gurth-2 (Koshaj)	338702	0.8
3	Gurth-3 (Plakëz)	200355	2.34
4	Perlat Verior	236275	1.68
5	Perlat Jugor	1402930	2.86
6	Derven	1248558	0.87
7	Rubik	958570	2.01
8	Thirre	333752	1.70
9	Kurbnesh	133470	1.30
10	Kaçinar	28734	0.63
11	Kullaxhi	372592	1.06
12	Lamskon	426950	0.85
13	Lëtiten	346196	1.05
14	Mashtërkor	101622	1.12
15	Lëgjin	444909	0.99
16	Laj-Reps	252646	0.97
17	Rrënjoll	47000	0.99
18	Objekte tjera	411868	1.03
	Shuma Mirditë	Σ12050990	1.418
1	Poravë	115000	1.5
2	Paluca Veriore	97450	1.05
3	Palucë Qëndrore	70915	1.82
4	Paluca Jugore	155261	1.32
5	Lak Roshë	1979060	1.452
6	Tuç	2100000	1.33
7	Tuçi Lindor	1700000	2.03
8	Rruga e Rinisë	1220000	1
9	Kodra e Keqe	289000	1.15
10	Qafë Bari (Verior)	338000	1.81
11	Munellë	6325245	1.175
12	Fushë Arrëz	282760	1.12
13	Micoj	636442	1.31
12	Kçirë	203000	1.9
13	Meçe	42350	1.3
14	Kabash	35000	2.6
15	Objekte tjera	1191196	1.08
	Shuma Pukë-Fush Arrëz	Σ16820679	1.349
1	Gjegjan	61000	3.56
2	Golaj	429600	0.62
3	Nikoliq (1+2)	1078000	1.75
4	Krumë	210000	3
5	Gdheshhtë	274000	1.3
6	Lepro	242100	1.36
7	Shikaj	596000	0.7
8	Objekte tjera	1313550	1.07
	Shuma Kukës+Has	Σ4204250	1.31
1	Bregu Geshtenjes	2095441	2.21

2	Çiflig	718180	2.32
3	Dushku i Trashe	253000	2.4
4	Rehovë (Kanisqel)	358000	1.81
5	Objekte të tjera	404200	1.66
	Shuma Korçë	Σ3828821	2.147
1	Palaj – Karmë (Vau Dejes	Σ1361000	2.5
1	Turec (Lezhe)	372900	0.85
2	Ojekte tjera (Lezhë)	25000	0.99
3	Lunik (Librazhd)	16620	1.68
4	Objekte- Mat	116645	2.34
5	Objekt - Dibër	44600	0.96
	Shuma Lezhë-Librazhd-Mat-Dibër	Σ575765	1.19
	SHUMA TOTALE E REZERVAVE	Σ38841505	1.48

Nga studiues gjeologë jepen edhe një sasi rezervash prognozë (të mundëshme) për objekte e shfaqje të mineralizuara të cilat janë fiksuar e dokumentuar por nuk janë kryer punimet e nevojshme të kërkim-zbulimit për ti kthyer në vendburime. Gjithashtu janë edhe vendburimet ekzistuese të cilat nuk janë të mbyllura (janë me prespektive të hapur si në shtrirje edhe në zhytje).

Rezerva Prognoze (mineral Bakri)

1.	Gurth - Spaç - Reps	1	milion
2.	Kullaxhi – Malaj	1	“
3.	Shebe – Perlat – Buzboj – Prosek	1.5	“
4.	Rubik – Vele – Mnele	1	“
5.	Kurbnesh – Kthelle – Bulshar	0.5	“
6.	Thirre - Shtrungaj	0.5	“

Mirdita mbi 5.5 milion ton

1.	Porav – Miliska	2	milion
2.	Qaf Mali – Lak Roshi	1.5	“
3.	Tuç – Srriqe	1	“
4.	Munell – Qaf Lisi	2	“
5.	Fush Arrez-Gjegjan	0.5	“

Fush Arrez mbi 7 milion

1.	Petkaj-Asdre-Gdheshte (Kukes)	1	milion
2.	Nikoliq - Krume (Has)	0.5	“
3.	Karme – Shllinze (Vau Dejes)	1	“
4.	Rehove – Çiflig (Korçe)	2	“
5.	Te tjera (Lezhe, Librazhd, Mat, Elbasan)	0.5	“


Shuma e rezervave indikativë (prognoze) eshte mbi 17.5 milion ton mineral bakri.

-3.2.1- Vendburime minerare ne shfrytëzim

-Vendburimi ne Munelle

-Vendburimi Lak-Rosh.

Keto vendburime kane filluar te shfrytëzohen prej vitit 2005 deri 2015 nga nje kompani koncesionare “Beralb” shpk, e cila ka edhe vendburime te tjera minerare, per t’i shfrytëzuar dhe realizuar prodhimin e koncentratit te bakrit.



Pamje e vendburimit kryesor te bakrit ne Munellë (rajoni Puke)

-3.2.2- Vendburime te dhëna per shfrytëzim

-Vendburimet: Tuç; Qaf-Bari; Paluce; Fushe-Arrez (rajoni Puke)

-Vendburimi Karme (rajoni Shkoder)

Keto vendburime i ka marre per shfrytëzim kompania koncesionare “Beralb” shpk

Nderkohe aktualisht deri ne vitin 2016, kane hyre ne kete industri si operatore edhe dy kompani te tjera, “Tete-Tunel&Mining”shpk, (vendburimin e Spaçit ne Mirdite) dhe “Tirex” shpk, vendburimin e Bregut te Geshtenjes ne rajonin e Korçes.

Edhe këto te dy kompani parashikojnë procesin e prodhimit deri ne koncetrat bakri.

3.2.3 Paraqitje tabelare e rezervave sipas standarteve bashkekohore

Nr	Emertimi	Sipas studimit te viti 2014						
		Burime minerale		Rezerva				
		te matura		Te Provuara		Te mudshme		Indikative
		Sasia mln ton	% Cu	Mln ton	% Cu	Mln ton	% Cu	Milion ton mineral
1	Spaç	4.668	1.23	3.274	1.21	1.394	1.23	0,3
2	Gurthi 1,2,3	0.4	2.97			0.4	2.21	0,4
3	Rubik	0.968	2.01	0.65	2.12	0.318	1.78	1
4	Kullaxhi	0.372	1.06			0.372	1.06	1
5	Reps	0.253	0.97			0.253	0.97	0,3
6	Thirra	0.333	1.7			0.333	1.7	0,5
7	Letiten	0.346	1.05			0.346	1.05	
8	Legjin	0.445	0.99			0.445	0.99	
9	Lamkson	0.427	0.85			0.427	0.85	
10	Shum 1 zona e Spaçit	8.212	1.342	3.924	1.297	4.288	1.375	
11	Kurbnesh	0.133	1.3			0.133	1.3	0,5
12	PerlatVerior	0.236	1.68			0.236	1.68	
13	Perlat Jugor	1.403	2.88	1.403	2.88			1,5
14	Derven	1.248	0.98			1.248	0.98	
15	Kaçinar	0.0287	0.63			0.029	0.63	
16	Renjolle	0.047	0.99			0.047	0.99	
17	Shuma 2	3.0957	1.905	1.403	2.88	1.693	1.585	
I	Mirdita	11.3077	1.496	5.327	1.578	5.981	1.446	5,5
1	Tuçi + Tuçi Lindor	3.8	1.64	2.03	2.22	1.77	1.33	1
2	Paluce	2.356	2.35	1.296	2.35	1.06		
3	Lak-Roshi	1.98	1.452	1.216	1.5	0.764	1.34	1,5
4	Munelle	6.32	1.3	4.145	1.3	2.175	1.3	2
5	Rr.Rinise	0.387	1			0.387	1	
6	Fushe-Arrez	0.15	1.71			0.15	1.71	0,5
7	Fushe Arrez-Micoi	0.839	1.35	0.571	1.35	0.268	1.35	
8	Kçire	0.116	1.45			0.116	1.45	
9	Porave							2
10	Qaf-Bari verior dhe Jugor	0.338	1.81			0.338	1.81	
11	Te tjera1							
II	Puka Shuma	16.286	1.63	9.258	1.76	7.028	1.285	7
1	Gjegjan	0.061	3.5			0.061	3.5	
2	Shemri	0.449	1.36			0.449	1.36	
3	Gdheshte	0.274	0.98			0.274	0.98	1
4	Leproj	0.241	1.36			0.241	1.36	

III	Shuma Kukesi	1.025	1.385			1.025	1.203	1
1	Golaj	0.429	0.6			0.429	0.6	
2	Nikoliq e rreth tij	0.86	1.28	0.557	1.32	0.303	1.2	
3	Krume (Has)	0.056	4.4			0.056	4.4	0,5
4	Te tjera							
IV	Shuma Hasi	1.345	1.193	0.557	1.32	0.788	1.101	0,5
1	Karme	0.963	2.5	0.963	2.5			1
2	Te tjera, Turec e Mnele vig	0.469	1.11			0.469	1.11	
V	Shkodra	1.432	2.045	0.963	2.5	0.469	1.1	1
1	Rehova	0.24	1.83			0.24	1.83	2
2	B.Geshtenjes	1.73	2.09	1.73	2.09			
3	Shipak	0.15	1			0.15	1	
VI	Korça	2.12	1.98	1.73	2.09	0.39	1.51	2
	Te tjera (Lezhe, Librazhd, Mat, Elbasan							0,5
	Gjithsej	33.5157	1.60	17.83	1.74	15.68	1.33	17,5

Koment: Mineralet e bakrit jane natyre sulfide dhe kane si bashkëshoqërues edhe arin, argjendin, selenin etj. Permbajtja mesatare e arit ne këto rezerva minerare varion 0,5 – 1 gr/ton, ndërsa argjendi 10 deri 15 fishin e permbajtjes se arit.


-3.2.4- Vendburime minerare te lira

- Miniera e bakrit Perlat (Mirdite)


-Miniera e bakrit Derven (Mirdite)

-Miniera e bakrit Thirre (Mirdite)

-Etj



Harta e vendburimeve te bakrit



Harta e vendburimeve te bakrit dhe objekteve përpunuese metalurgjike



© 1992

Harte e vendburimeve minerare dhe përpunuese te bakrit, etj

-4- Te dhëna per objekte përpunuese ekzistuese.

4.1- Pasurimi

Fabrike pasurimi ne Fushe-Arrez: objekt ne administrim te “Beralb” shpk kompanie private

-Kapaciteti përpunues : 300 deri 350 mije ton mineral ne vit

-Treguesit teknike: Shkalla e përfitimit te bakrit mesatare 80 % (tregues i ulet)

-Cilesia e produktit: % e bakrit ne koncentrat mesatare 18 dhe H₂O 10 deri 12 %

-Prodhimi mesatar vjetor: 25 deri 35 mije ton koncetrat



Pamje e Fabrikes se Pasurimit te Bakrit ne Fushe – Arrez (kompania “Beralb”)



Fabrika e Pasurimit ne Rreshen (objekt i ndërtuar ne vitin 1985, aktualisht i lire)

Gjendja teknike e saj

Objekti eshte i dëmtuar dhe disponon vetëm ndërtesat te cilat kane dëmtime pjesore:

- a- Korpusi kryesor i fabrikës
- b- Laboratori fizik
- c- Sektori elektromekanik
- d- Zyra administrate dhe laborator kimik
- e- Kaldaja
- Peshore e mjeteve
- Linje tesnsioni TN 6 kva

Fabrika ka edhe venddepozitimin e mbetjeve te pasurimit

Siperfaqe e saj $S = 18500 \text{ m}^2$ (miratuar me VKM 349 date 12.05.2010 (e pa regjistruar ne ZRPP). Jane depozituar rreth 300 mije teon mbetje teknologjike te ngurta nga pasurimi.

Kapaciteti projektuar

Perpunim mineral bakri 60 mije ton/vit (per mineral nga Vendburimi Derven, dhe Perlat Mirdite)

Treguesit e projektit (Rekuperim bakri $Re = 80$ deri 85% , koncentrat me cilësi 16% Cu)



Pamje e fabrikës se pasurimit te bakrit ne Rreshen (objekt i lire)

Te dhëna te tjera :

Siperfage nen objekt $S = 1450 \text{ m}^2$

Siperfage totale $S = 13.956 \text{ m}^2$ (pa damben)

Pronesia: Shtet

Vendndodhja: Rreshen

Distanca e saj me vendburimet e bakrit ne Mirdite:

-Nga Vendburimi Perlat 15 km

-Nga Vendburimi Spaç + Gurth-Spaç 20 km

-Nga vendburimi Derven 5 km

-Nga Vendburimi Rubik 10 km

-4.2- Metalurgjia : Uzina e Rafinimit të Bakrit në Rubik

Te dhëna kryesore

Vendndodhja: Qyteti Rubik, Bashkia Rreshen, rrethi Mirdite, qarku Lezhe.

Skema e saj funksionale dhe gjendja aktuale

Kjo uzine eshte projekt i zbatuar nga kinezet dhe eshte vene ne pune me kapacitet te plote ne mars te vitit 1968, me **keto reparte** :

-Rafinimin anodik, me furre stacionare (me perdorim lende djegese solar me permbajtje te ulet sqfuri) e cila realizonte rafinimin e bakrit blister me derdhjen pastaj ne forme anode (cilesia rreth 99,7 % Cu).

-Rafinimin me elektrolize, per realizimin e pastrimit te bakrit anodik prej papastertive e perfitim te bakrit elektrolitik, e ku sipas projektit ishin 115 banjo prodhimi (vaska elektroilze) e 10 banjo pergatitore te fleteve mëmë per proces. Kapaciteti maksimal i projektuar per reaprtin arrin 6500 ton/vit, baker elektrolitik me cilesi mesatare 99,95 – 99,97 % Cu.

Ky produkt pas rishkrirjes e prodhimit te lingotave kishte destinacion Uzinen e Telave dhe Kablllove ne Shkoder (projekt edhe ky kinez ne sinkron me ate te rafinerise Rubik realizuar ne vitin 1967) nga ku prodhohej tela e kablllo rreth 8 deri 10 mije ton/vit. **(aktualisht makineri-paisjet e ketyre reparteve jane te demtuara)**

-Reparti i perpunimit te shllamit anodik dhe solucioneve te elektrolizes.

Ne kete repart realizohet perpunim i shllamit anodik qe rezultonte si mbetje nga elektroliza e bakrit, duke perfituar Arin, Argjendin, Selenin, Sulfat bakri e nikeli prej perpunimit te solucioneve te elektrolizes se bakrit, e ne fund mbetesh edhe sasira minimale Kripera Platini dhe Palladiumi. *(Aktualisht makineri-paisje jane te demtuara)*

-Repartet e prodhimit e perpunimit te aliazheve te bakrit

-a- Reparti i shkrirjes së aliazheve, qe prodhonte tunxh e bronx bllok dhe pllake (derdhje vertikale ne forma tip), duke perdor mbetje aliazhe bakri si dhe baker elektrolitik e shtesat

perkatete zink, kallaj e plumb sipas markes se prodhimit. Ky repart kishte dy furra elektrike induktive me kapacitet $Q=300$ kg, e prodhonte mesatarisht ne vit rreth 2000 ton/vit. **(aktualisht makineri-paisjet e demtuara)**

-b- Reparti i petezimit ne te ftohte i tunxhit per te realizuar prodhimin e fleteve te tunxhit me dimension nga 0,35 mm deri 7 mm e gjeresi nga 150 mm deri 300 mm, kryesisht me destinacion industrine ushtarake per prodhimin e gezhojave, por edhe per sektore te tjere te ekonomise, si industria e prodhimeve artistike, prodhim mullinj kafeje, e prodhime te tjera.

Kapaciteti prodhues varionte 1500 – 2000 ton/vit. **(aktualisht makineri e paisje jane plotesisht te demtuara)**


-Ne vitin 1987 eshte vene ne shfrytezim edhe nje repart tjeter per prodhim te fleteve bimetalike (Investim Italian ne koperim me firma te tjera te huaja), qe do te realizonte prodhimin e shiritave bimetalike (çelik te veshur me tunxh) edhe ky produkt per destinacion te industrise ushtarake, por qe nuk arrit te konsolidohej plotesisht. Nga provat me ngarkese deri ne vitin 1991 jane arritur te prodhohej mesatare rreth 30 – 50 ton/vit, **(Aktualisht makineri-paisje etj te demtuara)**

Theksojme se deri ne vitin 1990 –te, gjithë mbetjet e bakrit dhe aliazheve te tij (tunxh, bronx) grumbulloheshin sipas nje skeme mbeshtetese duke bashkerenduar edhe me Uzinen e Telave dhe Kablllove per skarcitetet industriale) e perpunoheshin ne Uzinen e Bakrit ne Rubik. Sipas statistikave, rreth 10 – 15 % e metalit baker te prodhuar total ne shkalle vendi arrihej te perfitohej prej mbetjeve te tilla

Sektore ndihmes : Reparti i kaldajave per prodhim avulli teknologjik (elektroliza e sektore te tjere e ngrohje repartesh) me kaldaje me kapacitet $Q = 6,5$ ton/ore (dy kaldaja), me perdorim lende djegese mazut. **(aktualisht makineri-paisjet e demtuara)**

- **Kjo Uzone ka funksionuar deri ne vitin 1999 me dy sektoret ate te prodhimit te bakrit** blister (project dhe ndertim Italian ne vitet 1940) e sektorin e Rafinimit projekt kinez, ne perberje te gjithë skemes se prodhimit te bakrit ne shkalle vendi e cila ka qene me cikël te plote

Me vone pas nje konçensioni te dhene nga qeveria, kompanise turke “BER-ONER” ne vitin 2001, ishte parashikuar te administronte e zhvillonte disa sektore te industrise se bakrit



Pamje e Uzines se Rafinimit te bakrit Rubik

nder te tjera edhe dy Uzinat ne Rubik (Shkrirje e Rafinim bakri), por me vone, keto objekte u lane jashte marreveshjes qe ne vitin 2005.

Si rrjedhoje e nje mungese strategjie te plote per kete industri, thuajse jashte vemendjes per riaktivizim, me gjithë rritjen e konjuktures se çmimit ne burse e metaleve baker, ar, etj pas vitit 2004 e vazhdim, kemi kete situatë:

Uzina e shkrirjes është demoluar ne vitin 2008, ndersa Uzina e Rafinimit te Bakrit është akoma e pademoluar por natyrisht me makineri e paisje te shkaterruara, dhe nje amortizimi te objekteve etj.

Ka nje infrastrukture pjesore inxhinierike, si linjen e furnizimit me uje dhe energji, apo sistemin e ujra-kanalizimeve etj. Rruget dhe sheshet jane por doemos kane nevojë per sistemime e ndonje riparim.

Nga nje vleresim e perafert per rehabilitimin e kesaj Uzine nevojiten rreth 3 milion \$ makineri-paisje dhe ndertim montime per elektrolizen, rafinimin me flake dhe shkrirje aliazheve, kaldate per prodhim avulli dhe Laborator se bashku me permiresimin e infrastruktures inxhinierike (linje uji dhe energjie e kanalizimet).

Statusi juridik aktual i objektit :

Deri ne vitin 2015 rezultonte dhene me konçesion te formes “ROT” (Rehabilitim, operim dhe transferim) nje shoqërie konçesionare, per pershtatje per prodhim ferrokromi karbonik.

Por referuar keqadministrimit te ketij objekti prej koncesionarit, Ministria e Energjise dhe Industrise, pas kontrollit te kryer ne vitin 2014, ka konkluduar per zgjidhjen e kontrates se koncesionit, proces i cili tashme është mbyllur me proceduren e marrjes ne dorezim te objektit prej koncesionarit duke e kaluar perseri ne administrim te “Albaker” sha ne likuidim ne Tirane.

Vend ndodhja :

Ne hyrje te qytetit Rubik (jug Lindje), anen e djathte e rruges nacionale Dures-Morine.

-Siperfaqe totale e shesheve e rrugeve e objekteve : 4,7 ha (**shih Planimetrine**)

-Kubatura e objekteve te Uzines 54 000 m³ (pa rep.Bimetalit) dhe rreth 60000 m³ totale.

-Siperfaqe e ndertimit 9500 m²; -Koficienti ndertimit rreth 25 %

- Pronesia: Shtet



Pamje e mjedisit te zones ku është ndertuar Uzina

Lidhja me infrastrukturën kombetare:

Ndodhet pranë rrugës nacionale Tirane-Kukes – Morine

-Distanca e saj me Fabrikat e pasurimit :

Me Fabriken e pasurimit ne Fushe-Arrez 60 km

Me Fabriken e Pasurimit Rreshen 10 km

Me Fabrike Pasurimi ne Spaç 25 km

Me Uzinën e Telave dhe Kablllove Shkoder 75 km

Me portin Shengjin 35 km

Me portin Durres 70 km

4.4- Mbi mundësinë e ndërtimit të një fabrike shkrirje në territorin e kësaj Uzine.

Nisur nga kapacitete përpunimi në nivele të ulëta, sipas vlerësimit të tone, një skemë ide, për punë me kapacitete të vogla përpunimi, mund të jetë briketimi i koncentrateve të bakrit dhe fluseve metalurgjike, shkrirje e tyre në furë vertikale pus (vatër xhakete), e pastaj konvertimi i metalinave të bakrit për prodhim bakri blister, shoqëruar edhe me skemë klasike për pastrimin e gazeve (modeli kamer precipitimi, ciklon dhe pastaj modeli me rrugë të njome e përdorim gëlqere për kapjen e SO₂, në kullë vertikale SCRUBBER). Kjo skemë mendojmë se është e mundur të kompozohet brenda territorit të Uzines së Rafinimit. Madje sipas mendimit të tone, kjo realizohet duke përshtatur dy objekte ekzistuese (ndërtesat e bimetalit dhe kaldaja) dhe realizuar lidhje organike të tyre, me sektorin e rafinimit.

Në këtë objekt sipas vlerësimit të tone mund të investohet për riaktivizim pjesor të sektorëve aktual, me riciklimin e mbetjeve metalike të bakrit dhe lidhjeve të tij, mbasë e shoqëruar edhe me mbetje elektronike. Bazë për këtë është një furnizim nga vendi minimal 2 mijë ton në vit, mbasë me synim edhe importi nga vendet fqinje Kosova e Mali i Zi që nuk kanë linjë të tilla riciklimi. Në sinkron, të ecurisë së investimit në miniera e pasurim dhe bazuar në lenden e parë koncentrat bakri që mundësohet, si nga vetë kompania edhe nga operatorë të tjerë vendas që sot janë pjesë e kësaj industrie, përcaktohet investimi në shkrirje për prodhim bakri blister. Pavarsisht këtij opinioni, që sipas këndvështrimit të tone dhe disa llogaritjeve paraprake, rezultoi si variant optimal investimi në Uzinën e Rubikut, është e drejtë e investitorit që të bëjë një vlerësim tekniko-ekonomik për të investuar në ciklin e shkrirjes, në dy variante :

-a-Ndërtim të uzinës së shkrirjes në territorin e Uzines së Rafinimit.

-b- Ndërtim të saj në një territor tjetër. Kjo procedurë lidhet me shkallën e interesimit të investitorit si dhe analizën e plotë midis varianteve.

PLAN RILEVIMI

UZINA RAFINIMIT BAKRIT RUBIK

PREGATITI

IDENTIFIKIMI I PASURISE


Emri LUIGJ MARKU
Licensa Nr. 0389 Data 29.07.2002
Data e pregatitjes 1/1

TOPOGRAFI
LUIGJ MARKU
LIC. TZ. 0389

ZONA KADASTRALE 3244
Nr. I PASURISE VOL. FO.
INDEKSI I HARTES
SHKALLA 1:2000
ADRESA E PASURISE: Rrethi MIRDITE
Q/ RUBIK Rr/L
P/G SH K Ap
PRONARI UZINA BAKRIT RUBIK

LEGJENDA

- 1.8/1 Zyrrat administ.
- 2.8/2 Rep. selenit
- 3.8/3 Banjo gardorobe
- 4.8/4 Laborator, bufe vend-roje
- 5.8/5 Shllam dhe posta-blokk
- 6.8/6 Elektroliza
- 7.8/7 Petzimi ftohte
- 8.8/8 Reparti Hiri i kockave
- 9.8/9 Rep. Rafinimit
- 10.8/10 Rep. Shkrirjes
- 1.8/11 Mag. qymyrit
- 2.8/12 Brig. Mekanike
- 3.8/13 Kaldaje e Orheku
- 4.8/14 Stacioni pompave solarit
- 5.8/15 Mag. Materjaleve
- 6.8/16 Rep. Bimetelit
mag. e argonit, gabi-
na elektrike



Planimetria e Objekteve te Uzines se Rafinimit te Bakrit ne Rubik

4.4- Uzina e Telave dhe Kabllove ne Shkoder

Vendndodhja: Rajoni industrial bashkia Shkoder

Te dhëna kryesore:

Siperfaqe e përgjithshme $S = 85$ mije m²

-Siperfaqe nen objekt $S = 40712$ m²

-Siperfaqe e rrugëve dhe kanalizimeve $S = 14\,822$ m²

-Siperfaqe e lire (lulishte trotuare) $S = 29\,466$ m²

Objektet kryesore:

-Kaldaja (Kaldaja e vjetër dhe e re)

-Reparti petëzimit (ky bazohej mbi skemën qe lidhej me përpunim bakri nga Uzina e Rubikut)

-Reparti i telëzimit

-Reparti i Telezimit dhe veshjes me PVC

-Reparti i zmalimit

-Reparti i ri dhe prodhimit te kabllove (investim Gjerman viti 1987)

-Reparti i barabaneve

-Reparti i bobinave

- Laboratori

-Magazina te ndryshme (Magazine per lende djegëse, lende te para, produkt gatshëm etj)

-Sektori elektromekanik (Reparti ofiqines dhe elektrik)

-Salla e kompresorëve

-Stacioni pompave


-Zyrat e administratës

-Mjedise per trajtim te personelit (ish Mence- bufe)

-Infrastruktura inxhinjerike (rruge e sheshe, sistemi furnizim me uje dhe energji dhe kanalizimet etj) –

-Nenstacion elektrik

Paraqitje skematike e planimetrisë se objekteve:



Planimetria e objekteve te Uzines se Telave dhe Kablove ne Shkoder

Kjo uzine eshte projekt kinez i viteve 1965, dhe eshte ndërtuar paralelisht me Uzinën e Rafinimit të bakrit në Rubik, duke finalizuar përpunimin e plote të bakrit në vend.

Kapaciteti i projektuar varionte 8 deri 10 mijë ton/vit sipas një strukture të orjentuara për tregun vendas dhe eksport. Në vitet 1985 deri 1987 është realizuar një investim gjerman duke ndërtuar dy reparte që realizonin prodhimin e telave të hollë dhe kabllotë të fuqisë.

Në vitin 2004 ky objekt është dhënë me koncesion një kompanie turke “Yilmaz kablo”, e cila realisht nuk ka arritur të realizojë parametrat e kontratës, si dhe nuk ka investuar në mirëmbajtjen e objekteve dhe infrastrukturën inxhinjerie, rrugë, sheshe etj.

Kjo ka sjellë amortizim të shumë objekteve dhe dëmtime të makineri-pajisjeve të trashëguara, sepse nuk janë zbatuar kriteret e një ruajtje dhe konservimi teknik të tyre.



Pamje e Uzines se Telave dhe Kabllave Shkoder (viti 2014)

Gjendja teknike e saj:

Referuar një ecurie jo optimale të periudhës së punës me koncesion (2004 deri 2016) vëhet se një shkallë e lartë amortizimi të makineri-pajisjeve të cilat nuk janë përdorur nga kompania, madje linjat e reja të viteve 1985-1987 (gjermane) janë dëmtuar duke mos i ruajtur e konservuar siç duhej.

Një dëmtim të madh kanë edhe objektet ndërtimore sepse nuk është investuar për mirëmbajtjen e tyre, e po kështu në disa sektorë si kaldaja, reparti i petëzimit etj janë thuajse jashtë përdorimit. Dëmtime vihen re edhe në rrugë e sheshe si dhe një pjesë infrastrukturë inxhinjerie.

Më situatën e krijuar mund të themi se për vazhdimësinë e punës në këtë objekt është e domosdoshme një rehabilitim tërësor si në rrugë e sheshe dhe objekte ndërtimore si dhe futjen e linjave dhe makineri –pajisje bashkëkohore jo vetëm për tela e kabllotë, por ka mëjdisë

edhe per mundësi aktivitete te tjera si prodhime elektrike te ndryshme, paketa elektronike per mjetet, prodhim elektromotorësh etj

Lidhja me infrastrukturën kombetare:

Eshte ne qytetin e Shkodres

Distanca me piken doganore Hani Hotit	34 km
Distanca me piken e Muriçanit,	17 km
Distanca me portin e Shengjinit,	60 km
Distanca me portin e Durresit,	120 km
Distanca me piken doganore Morine,	180 km

Statusi juridik:

Ky objekt eshte dhene me koncension ne vitin 2004 por nga kontrollet periodike prej strukturave shteterore eshte arritur ne konkluzionin per zgjidhje marrëveshje sepse nuk ka zbatuar detyrimet. Tashme eshte ndjekur procedura per zgjidhje te marrëveshjes koncesionare, kalim provizor ne administrim prej shtetit dhe promovim per nxitje interesi prej investitorëve te interesuar per administrim dhe zhvillim te këtij objekti.

-5- Lenda e pare e cila mund te sigurohet ne tregun vendas ne ciklin e perpunimit:

-5.1- Koncentrat bakri nga kompania ekzistuese “Beralba” shpk, parashikohet 25 – 30 mije ton vit cilësia 18 % Cu per periudhe 15 vjeçare, deri vitin 2032 (periudhe e kontratës koncesionare) dhe pastaj përsëri 5 vite te tjera deri 2037 me vendburimet e rajonit te Pukes dhe Shkodres

Si rrjedhoje 20 vite parashikohen nga ky rajon mesatare 25 – 30 mije ton koncentre ne vit me 18 % Cu

-5.2- Koncentrat bakri nga kompania operatore “Tete – Albania Tunel & Mining” shpk, rreth 20 mije ton/vit, cilësia 20,% Cu

Sipas informacionit kompania turke “Tete-Albania Tunel & Mining” ne minierën e Spaçit parashikon qe prej vitit 2018 deri 2028, prodhim mesatar vjetor koncentrat bakri me 20 % Cu, ne sasinë prej 19,7 mije ton.

5.3- Sipas informacionit te kompanisë “Tirex” shpk, per peiudhen 2019 deri 2028, parashikon rreth 4 mije ton koncentrat bakri ne vit, me cilësi 20 % Cu.

Natyrisht se me disa vendburime te vogla rreth Spacit, si dhe kërkim zbulime per rezerva te reja, kjo kompani mund te vazhdoje me tej edhe se paku per 5 vite te tjera vetëm me rezervat e disa burimeve ne afërsi te fabrikës se pasurimit,.

Paraqitje tabelare per nje periudhe 10 vjeçare e prodhimit te koncentratit te bakrit nga kompanitë qe kane ne administrim objekte minerare dhe pasurimi te bakrit, sipas informacioneve te tyre eshte si vijon:

Emertimi kompanise	Njesia	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
-1- Beralb shpk	Mije ton	5,79	15,93	24,96	30,55	32,14	35,34	33,41	31,2	30,9	28,6	28,6
-2- Tete-Mining	Mije ton	19,7	19,7	19,7	19,7	19,7	19,7	19,7	19,7	10,2	10,2	10,2
-3- Tirex shpk	Mije ton	-----	4,14	4,14	4,14	4,14	4,14	4,14	4,14	4,14	4,14	4,14
Shuma	Mije ton	25,49	39,77	48,8	54,39	55,98	59,18	57,25	55,04	45,24	42,94	42,94

Koment:

Referuar bilancit te këtij dokumenti, per sasinë rezervave te nxjerrshme per vendburimet qe ka marre ne shfrytëzim kompania **“Beralb” shpk**, (ne rajonin Puke dhe Shkoder), mbeten akoma per shfrytëzim rreth 6 milion ton mineral nentoke me cilësi 1,76 % Cu.

Nisur nga nje tregues humbje e varfërim jo me shume se 10 % kemi akoma lende te pare nga minierat per pasurim rreth 6 milion ton me cilësi 1,58 % Cu. Me me shkalle rekuperimi ne

pasurim 85 % e kapacitet përpunimi mesatare cdo vit 400 mije ton vazhdon puna edhe per 15 vite me prodhim koncentratit vjetor : $447518 \text{ ton} : 15 = 29834 \text{ ton koncentrat/vit}$.

Duke u bazuar dhe ne nje mundësi per shfrytëzimin e rezervave te vlerësuara te mundeshme (sipas tabelës përkatëse te gjithë rezervave minerare), ne objektet minerare qe kjo kompani ka marre per shfrytëzim, te cilat jane rreth 7 milion ton me cilësi 1,285 % Cu, me shkalle vërtetësie minimale 35 % (C2), dhe humbje varfërim 15 % kemi :

Rezerva nga nëntoka 2,5 milion ton me cilësi 1,13 % Cu per ne pasurim, ose per kapacitet 400 mije ton arrin edhe 6 vite pune ne pasurim.

Ne total vetëm prej objekteve minerare te kompanisë “Beralb”shpk, mund te prodhohen rreth 8,22 milion ton mineral me 1,45 % Cu ne pasurim, optimale per çmimin e bakrit mbi 4500 \$/ton

Prandaj vetëm nga këto vendburime qe kjo kompani ka marre per shfrytëzim dhe prodhim koncentrat bakri, (pa parashikuar shtim te rezervave nëpërmjet kërkim-zbulimit) sigurohet ecuri prodhimi edhe 21 vite pas vitit 2027(deri ne vitin 2047) natyrisht me mesatare prodhim koncentrat bakri 29 deri 30 mije ton/vit.

-Per vendburimet ne rajonin e Korçes nga kompania “ Tirex” shpk, parashikohet rreth 17 vite shfrytëzim dhe prodhim ne total rreth 70,45 mije ton concentrate bakri me 18 % Cu (mesatare vjetore 4,14 mije ton), nga viti 2019 deri ne vitin 2036

5.4- Pjesa tjetër nga : Vendburimet e lira Perlat dhe Derven Mirdite,

Mirdita: Perlat dhe Derven : me 150 mije ton/vit përpunim kemi 12 vjet pune.

Periodha e mundeshme per parashikim prodhim koncentratit mendohet viti 2020 dhe vazhdim, ose kjo sasi koncentratit prej rreth 11 mije ton/vit nga viti 2020 deri vitin 2032

Kemi rreth **11 mije ton concentrate vit me 20 % Cu**

Kjo sasi mendohet te filloje 2020 deri 2032 (12 vite), ose mesatare cdo vit 11 mije ton

-5.5- Me rezervat e mbetura te mundshme, (sipas tabelës se rezervave), jane rreth 4,5 milion ton me 1,09 % ose te nxjerrshme rreth 2,5 milion ton me 1 % Cu

Nisur nga kjo tablo e lendes se pare dhe prodhimit te koncentratit te bakrit, parashikohet se prej vitit 2019 deri ne vitin 2038 (periudhe 20 vjeçare) kemi mundësi sigurim prodhim koncentrat bakri mesatare 45 deri 50 mije ton/vit ose produkt final bakër te pastër nga elektroliza 7800 deri 8500 ton/vit apo mesatare rreth 8 mije ton/vit.

Njekohesisht sipas SHGJSH kemi edhe pritshmëri per rreth 17,5 milion ton rezerva te reja ne baze te disa kërkimeve paraprake por jo te mbështetura me ndonjë investim te thelluar te paraqitura ne tabelën e rezervave, emërtuar si indikativë.

Burime dytesore bakri

5.6 --Te dhëna per mbetjet metalike te bakrit dhe lidhjeve te tij qe eksportohen te papërpunuara Sipas e dhënave nga dogana, per periudhën 2004 deri 2015, sasia e mbetjeve metalike (skrape) te bakrit dhe lidhjeve te tij (tunxhe, bronzë), varion mesatare nga 3 deri 4 mije ton/vit, te cilat dalin ne eksport te papërpunuara. Prognoza ne te ardhmen mendohet te varioje 2 deri 3 mije ton/vit, por duke mundësuar edhe importimin e tyre prej dy vendeve fqinje, Kosove e Malin e Zi, qe aktualisht nuk disponojnë linje per riciklimin e tyre.

Bazuar ne këto te dhëna, rezulton se me keto burime ku kryesore jane mbi baze metali nga miniera, dhe shtese nga riciklimet e skrapeve metalike bakërmbajtëse, sigurohen kushtet optimale per nje investim ne ciklin e përpunimit.

Nga kjo tablo, përveç interesimit per te rritur shkallen e përpunimit ne vend te lendes se pare minerare, si faze e pare mund te jete investimi direkt ne Rubik dhe Shkoder, per mundësi sinkronizimi te përpunimit te mbetjeve metalike dhe prodhim lende te pare per tela e kablo se paku per 500 deri 1000 ton si fillim, pastaj edhe ne vartësi te mundësive investimi ne sektorin e shkrirjes.

Një skemë Ide për sinkronizim te ciklit të përpunimit të bakrit është e tillë:

- a- Investimi ne objektet e lira minerare dhe pasurim te tyre (kryesisht vetëm ne Mirdite)
- b- Investim per riaktivizim te ish Uzines se Rafinimit te Bakrit Rubik ne sinkron me ate te telave dhe kabllove ne Shkoder, si faze e pare, duke organizuar pune vetëm me mbetje bakri e lidhjeve te tij me kapacitete 2 deri 3 mije ton/vit
- c- Investim ne ciklin e shkrirjes te koncentrateve te bakrit qe sigurohen nga vendi operatorët aktual dhe vendburimet e lira minerare.
- d- Lidhje organike e plote e skemës deri ne tela e kablo.
- e- Mundesi investimi per produkte te tjera sidoemos ne Uzinen e Telave Shkoder, përveç tela e kablo, mund të prodhohen paisje elektrike, elektromotorr elektrik etj

-6- Vleresimi i perafert per mundësinë e investimit dhe shfrytëzimin e vendburimeve te lira dhe objekteve aktuale te përpunimit se bashku me ato te reja.

-a- Ne objektet e lira minerare rreth 12 milion \$ Perlat, Derven, Gurth, Thirre, ndërsa duke perfshire edhe objektet e tjera qe kane marre ne shfrytezim kompanitë operuese ne kete industri, investimi i përafërt ne miniera vleresohet rreth 55 milion \$.

-b- Ne pasurim minerali 15 milion \$ (tre fabrika pasurimi te reja, dy ne Mirdite dhe nje ne Korçe)

Gjithsej investimi ne miniere – pasurim (objekte te reja te kompanive operatore ne kete industri dhe atyre te lira) eshte vlerësuar rreth **70 milion \$**

Metalurgjia:

-c- Ne shkrirje 19 milion \$ (sektor shkrirje dhe linje per pastrimin e gazit)

-d- Ne rafineri 4 milion \$ riparime te ekzistueses + 2 milion \$ derdhje e panderprere

-e- Ne prodhim tela e kablllo 4,5 milion \$

Gjithsej metalurgjia: 29,5 milion \$

Total investime te reja qe sigurojnë kete lende te pare: **99,5 milion \$**

Referuar nje vlere interesi 5 % per periudhe 10 vjeçare shpenzime investimi arrin **ne 119 milion \$.**

Sipas nje vlerësimi paraprak nga strukturat tona studimore, per kof. humbje – varfërim me pak se 15 %; kosto nxjerrie jo me shume se 20 \$/ton mineral dhe kosto pasurimi 10 – 12 \$/ton mineral;; rekuperimi ne pasurim 85 – 87 % e cilësi koncentratit 20 % Cu, **per LME 5500 \$/ton bakër elektrolitik** (99,95 – 99,97 % Cu), vetëshlyerja e investimit ne gjithë ciklin e bakrit deri tela e kablllo **varion 7 – 8 vite.**

Natyrisht sipas mendimit tone, ka rezerva ne lidhje me rritjen e rekuperimit ne pasurim deri 90 %, por edhe ulje kosto nxjerrie me 2 \$/ton (ose nga 20 ne 18 \$/ton kosto nxjerrie nga nentoka) qe mundëson rritje efikasiteti e ulje kohe vetshlyerje, nga 7 ne 6 vite.

Nisur edhe nga nje vlerësim per përcaktim pike ekuilibri te prodhimit per çmim ne LME 5500 \$/ton Cu (bursa e metaleve), shpenzimeve fikse (investimi plus interesat) dhe atyre variabël / per nje ton produkt rezulton **se Q ekuilibrit eshte mbi 8400 ton/vit** prodhim bakër elektrolitik. Siç theksuam **rreth 7800 deri 8500 ton sigurohet nga lënda e pare koncentre bakri** dhe diferenca e metalit prej mbetjeve te bakrit

Jetëgjatësia e projektit : Per burime minerare mesatare 1,74 % Cu (nentoke) apo me rreth 1,5 % Cu minerali ne pasurim, arrihet deri 20 vite, ndërsa me rritje përpunimi ne pasurim cdo vit mineral me te varfër me 1 % Cu (ose 1,3 % nentoke), deri 30 % te sasisë vjetore, kemi jetëgjatësi deri 25 vite te projektit, bazuar ne rezervat e zbuluara dhe vërtetuara deri ne vitin 2016.

-7- Nevojat e tregut vendas per prodhime te bakrit

Tela e kablllo:

Nga nje informacion i përafërt kemi kete strukture kerkese tregu :

- Rrjeti elektroenergjetik, 450 ton/vit
- Industri , rreth 100 ton
- Objekte banimi dhe ndërtesa industriale e rezidenciale rreth 100 ton/vit
- Transport etj, 20 ton /vit
- Sektor shërbimesh (avolzhime elektromotorrash etj) 50 ton/vit;
- Nevoja per produkte tunxhi e bronzi (si rekorderi etj)

Nderkohe edhe referuar nje periudhe 11 vjeçare import produkte bakri jane **rreth 700 ton/vit (2005 deri 2015)**, sipas statistikave INSTAT dhe dogana. Ketu duhet patur ne konsiderate se këto te dhëna jane realisht sipas doganave, duke mos marre ne konsiderate, rastin kur ne sektorin elektroenergjetik jane investime direkte qe realizohen nga donatore te ndryshëm e madje nevoja per produkte bakri mund te jete perfshire si element investimi duke mos u trajtuar si mall dogane. Referuar te dhënave doganore te periudhës 2000 deri 2002 ku rezultonte import tela e kablllo dhe produkte bakri mesatare 4500 deri 5000 ton/vit, dhe faktit se gjate 15 viteve (viti 2000 deri 2015 jane bere mbi 400 mije ndërtime pa leje, qe realisht kane konsumuar tela e kablllo etj (mesatare 30 kg/ 70 m2 siperfaqe banimi), ose rreth 1200 ton/vit, mendohet se realisht konsumi ka qene me i larte se raportimi nga dogana.

Bazuar ne kete informacion, mendojmë se nevoja e tregut vendas duhet te jete mesatare vjetore jo me pak se 1000 ton per tela e kablllo e produkte prej bakri (tuba etj).

-8- Pozicioni i Shqiperise ne tregun rajonal per prodhime bakri

- Nisur nga konsumi mesatar vjetor per fryme popullsie ne bote si dhe nga te dhënat per rajonin e ballkanit rezulton se :

-Ne vendet e rajonit si Greqi, Serbi, Kroaci, Slloveni, Bosnje-Hercegovine, Maqedoni, Rumani e Bullgari ka Uzina per prodhimin e telave dhe kablllove, ndersa Mali i Zi dhe Kosova nuk kane te tilla.

Te dhëna për prodhim bakër te rafinuar elektrolitik nga vendet e Ballkanit (ne mije ton)

Shteti/viti	1986	1990	2002	2005	2007	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	11,7	10	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	
Jugosllavi	100	151,4	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	
Serbia			35,9	31,3	31,6	22,2	28,45	34,7	35,8	33	44
Maqedoni			-----	-----	-----	-----	-----	1,1	1,9	1,7	2,4
Rumania	44	27,7	13,45	20,74	18,6	4	---	---	---	---	---
Bullgaria	48	24,3	40,0	60,5	69,9	215,1	226,1	226,1	226,1	234	230
Qipro	2,3	2,5	3,7	---	3,012	2,595	3,66	4,328	4,4	4	2,1
Turqia	75,1	84,2	41,0	95,0	105,0	47,1	85	80	80,0	82	84
Gjithsej	281,1	300,1	134,05	207,54	228,11	290,99	343,2	346,23	348,2	354,7	362,5

Popullsia e vendeve te Ballkanit (63,6 milion) se bashku me Turqinë 72 milion arrin ne 135,6 milion banore ose rreth 1,99 % e popullsisë se botes.

Periudha 2002 deri 2015 kemi mesatare e prodhimit te metalit nga minierat e vendeve respektive rreth 190,27 mije ton metal bakri, rreth 190 mije ton (rreth 0,9 % e botes), **ose 1,4 kg/banor (rreth 58 % e mesatares se botes). Ketu rreth 4 % e ze Shqiperia, 65 % Bullgaria, 21 % Serbia, Rumania dhe Maqedonia me 4 % sejcila, etj.**

Mesatare e botes për periudhën 2002 deri 2015 është 16,2 milion ton metal nga minierat ose 2,4 kg/banor.

Prodhim bakri elektrolitik **vendet e Ballkanit** arrijnë mesatare vjetore 2002 deri 2015 rreth 258,17 mije ton, **apo rreth 1,9 kg/banor**

Mesatare e botes për periudhën 2002 deri 2015 për prodhim bakër elektrolitik është 19,7 milion **ton ose 2,89 kg/banor**

Sipas këtyre te dhënave rezulton se vendet e Ballkanit deri tani nuk kane arritur te prodhojnë bakër elektrolitik me shume se **65,7 % te mesatares botërore**

Shqipëria: mesatare e metalit te prodhuar nga minierat e saj për 2002 deri 2013 arrin 4,6 mije ton metal ne formën e koncentratit te bakrit, ose për fryme popullsie (4,2 milion banor) kemi **rreth 1,095 kg/banor**, rreth **43 % me pak se mesatare e vendeve te Ballkanit** dhe rreth **1,2 here me pak se mesatare e botes**. *Ndërkohe qe periudha 1980 - 1990 kur funksiononte me cikël te plote, arrinte mesatare 3,5 kg/banore, ose rreth dyfishin e mesatares se botes.*

Nga vendet e Ballkanit vetëm Bullgaria, Serbia dhe Turqia kane peshën kryesore ne prodhim bakri, nga burimet e tyre natyrore, ndersa Maqedonia përpunon deri koncentratat bakri



Te dhëna për konsumin e metalit bakër për fryme popullsie ne bote :

Treguesi Konsumi kg/banor i bakrit sipas periudhave	Periudha viti 1950-1960	Periudha 1970-1980	Periudha 1980-1990	Periudha 1990 - 2000	Periudha 2000-2005	Periudha 2007-2012	Periudha a 2015 - 2025
Bota (mesatare)	1,2 - 1,5	2 - 2,3	2-2,2	2-2,5	2,5-2,7	2,7 – 2,8	2,8 - 3
Shqipëria (mesatare)	0,7 – 1,1	1,7 – 1,8	1,8-1,9	1,2-1,4	1,5 – 1,6	0,25 tregues i ulet	

Nisur nga ky tregues qe flet për zhvillimin ne bote, pasi bakri është nder elementet kryesore i cili ka fushe te madhe përdorimi ne ekonominë e një vendi, duket qarte tendenca ne rritje e konsumit për fryme popullsie, ndërsa vendi ynë ka tregues me te ulet se mesatare e botes.

Ndërkohe theksojmë se tregu rajonal, pra nga vendet e Ballkanit me prodhimet e tyre, nëse synojnë te arrijnë një konsum bakri sa mesatare e botes (2,8 kg/banor) referuar popullsisë se saj 135,6 milion kërkohen rreth 382 milion ton metal bakri, ndërkohe qe me te dhënat e sipërcituara, siguron vetëm rreth 346,2 milion ton ose rreth 90,5 % te kësaj mesatare botërore, kur tashme konsiderohen vende me tendence zhvillimi.

-9- Kuadri ligjor rregullator qe mundëson nxitjen e biznesit dhe sipërmarrjes ne kete industri

-Legjislacioni per nxitjen e investimeve te huaja, **Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”**

-Legjislacioni minerar : Ligji nr. 10304 date 15.07.2010 “Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise” dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij (VKM, Udhezime e Urdhra te Ministrit)

-Legjislacioni per koncesionet, Ligji **Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”** ndryshuar

-Legjislacioni per qiradhënie simbolike me 1 euro ; **VKM-ja Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për Përcaktimin e kriterëve, procedurës e mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”** ndryshuar

-Legjislacioni per funksionimin e shoqërive te ndryshme tregtare si regjistrim biznesi, paisje me licensa etj.

-10- Lehtesira te mundeshme per investime ne kete industri, ne rastin e marrjes per administrim dhe zhvillim me cikël me te thelle përpunimi deri tela e kablllo:

-a- Me ligj te veçante, per rastin kur mund te kerkoje gjithë ciklin e bakrit (miniera deri tela e kablllo), marrëveshja koncesionare mund te miratohet nga kuvendi dhe mund te ofrohen per nje periudhe 5 vjeçare disa lehtësira si: tatim fitimi; takse doganore per makineri-paisjet qe do te instalohen per investimin ne ciklin e nxjerrjes, përpunimit deri ne tela e kablllo.

-b- Taksa per rentën minerare, me ligj mund te ulet deri ne 50 % ne rastin e rritjes se përpunimit deri ne bakër elektrolitik e tela e kablllo. Konkretisht nëse per deri ne koncentrat bakri do te jete 6 % e vlerës se mallit te shitur, per deri ne bakër elektrolitik, zbret deri ne 3 % e vlerës se mallit te shitur, ndërsa per tela e kablllo mund te ulet akoma deri ne 2,5 %.

-c- Nese perdoren ne ciklin e shkrirjes dhe rafinimit mbetje metalike, mund te aplikohet nje mekanizëm nxitës qe këto mbetje te jene te interesuara per përpunim ne vend, duke parashikuar qe eksporti i tyre pa përpunim do te kete takse, ndërsa per produktin final bakër metalik, qe del nga përpunimi i tyre jo.

-d-Per objektet aktuale te përpunimit si Fabrika e pasurimit ne Rreshen, Uzina e Rafinimit ne Rubik dhe Uzina e Telave ne Shkoder, mund te stimulohet dhënia me qira simbolike 1 euro per periudhe 20 vjeçare, me te drejte zgjatje, duke plotësuar kushtet per investim ne sejcilin objekt prej (X) milion euro dhe punësim (Y) veta, sipas legjislacionit te radhitur:

Legjislacioni per investimet strategjike ne Rep.Shqiperise (Liqji nr. 55/2015) parashikon :

-Investime strategjike ne fushat:

-a- Miniera; b- Zone e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik; c- Zone me perprasi zhvillimin e nje rajoni etj

Ne funksion te llojit te investimit, fushës etj ka disa perparsi ne lidhje me procedurat per aplikime dhe asistencën e institucioneve shtetore konkretisht:

-Ne fushen e minierave, Investimi > 30 milion euro, ka produre te asistuar, per Inv > 50 milion euro, ka prosedure te vecante

-Ne rastin e zonave teknologjike dhe zhvillimit ekonomik, Investimi > 5 milion euro, procedure e asistuar, per Inv> 50 milion euro me procedure te vecante

-Ne rastin e zonave me zhvillim te vecante, Investim > 1 milion euro dhe Punesimi > 150 veta me procedure te asistuar, per Investim > 10 milion euro dhe Punesimi > 600 veta me procedure te vecante

Ne këto raste merret direkt si institucion mbështetës AIDA (Agjensia e Zhvillimit te Investimeve te Shqiperise, ne vartësi te Ministrise përgjegjëse per Ekonomine)

Ligji Nr. 9789 datë 19.07.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” i ndryshuar me ligjin 54/2015 **“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9789, datë 19.7.2007, “për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” ka sa vijon :**

1. Zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik përfitojnë lehtësitë e mëposhtme:

Fiskalet

Nga një lehtësi qe ishte parashikuar ne ligjin e vjeter:

- Mallrat, që hyjnë në zonën e lirë nga personat e licencuar dhe shërbimet që u kryhen atyre brenda zonës së lirë, përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.
- Zhvilluesit dhe përdoruesit përjashtohen nga pagesa e 50% të normës së tatimit për 5 (pesë) vitet e para nga fillimi i veprimtarisë së tyre në zonë;
- Zhvilluesit ose përdoruesit që investojnë në zone brenda 3 (tre) viteve nga fillimi i veprimtarisë ekonomike të zonës u njihen si shpenzime të zbritshëm, të periudhës tatimore, 20 (njëzet) përqindja e shpenzimeve kapitale vjetore, pavarësisht nga shumat e amortizimit sipas ligjit për tatimin mbi fitimin, për një periudhë dy vjeçare;
- Furnizimi mallrave shqiptare të destinuara për t’u vendosur në zonë konsiderohen si furnizime për eksport me shkallë zero, në përputhje me përcaktimet e ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe legjislacionit doganor;
- Projekti i zhvilluesit përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;
- Ndërtimet e realizuara në këtë zonë, sipas projektit të zhvilluesit, përjashtohen nga taksa e pasurisë të paluajtshme për një periudhë 5-vjeçare;
- Zhvilluesit ose përdoruesit e zonës janë të përjashtuar nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;

- Shpenzimet për paga dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore që punëdhënësi paguan për punëmarrësin njihen 150% të vlerës gjatë vitit të parë fiskal të ushtrimit të aktivitetit. Në vitet në vijim shpenzimet shtesë për pagat në raport me vitin paraardhës për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm njihen si shpenzime të njohura me 150% të vlerës;
- Kostot e trajnimit të punonjësve në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm njihen si shpenzime të njohura të periudhës tatimore me dyfishin e vlerës për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare nga fillimi i veprimtarisë ekonomike;
- Shpenzimet për Kërkim Shkencor dhe Zhvillim njihen si shpenzime të njohura me dyfishin e vlerës për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare nga fillimi i veprimtarisë ekonomike.
- Mallrat mund të transportohen nga një TEDA në një tjetër pa paguar detyrimet doganore

Administrative

- Për të hequr burokracitë në drejtim të marrjes së lejeve nga zhvilluesit dhe përdoruesit është propozuar trajtimi i aplikimeve për leje të behet brenda 15 diteve nga institucionet përgjegjëse për dhenien e ketyre lejeve dhe në raste të veçantë mund të aplikojë dhe vetë institucioni përgjegjës me kërkesë të zhvilluesit.

b) zhvilluesit dhe përdoruesit përjashtohen nga pagesa e 50 përqindëshit të normës së tatimit për 5 vitet e para, nga fillimi i veprimtarisë së tyre në zonë;

c) zhvilluesit që investon në zonë, brenda 3 viteve nga data e fillimit të punimeve, ose përdoruesit që investon në zonë, brenda 3 viteve nga fillimi i veprimtarisë ekonomike të zonës, i njihen si shpenzime të zbritshme, të periudhës tatimore, 20 për qind e shpenzimeve kapitale vjetore, pavarësisht nga shumat e amortizimit, sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat, për një periudhë 2-vjeçare;

ç) furnizimi i mallrave shqiptare, të destinuara për t'u vendosur në zonë, konsiderohet si furnizim për eksport me shkallë zero, në përputhje me përcaktimet e ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe legjislacionit doganor;

d) projekti i zhvilluesit përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

dh) ndërtimet e realizuara në këtë zonë, sipas projektit të zhvilluesit, përjashtohen nga taksa e pasurisë së paluajtshme për një periudhë pesëvjeçare;

e) zhvilluesit ose përdoruesit e zonës janë të përjashtuar nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;

ë) shpenzimet për paga dhe kontributet shoqërore e shëndetësore, që punëdhënësi paguan për punëmarrësit, njihen 150 për qind të vlerës gjatë vitit të parë fiskal të ushtrimit të aktivitetit. Në vitet në vijim, shpenzimet shtesë për pagat, në raport me vitin paraardhës, për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, njihen si shpenzime të njohura me 150 për qind të vlerës;

f) kostot e trajnimit të punonjësve në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, njihen si shpenzime të njohura të periudhës tatimore me dyfishin e vlerës, për një periudhë 10-vjeçare nga fillimi i veprimtarisë ekonomike;

g) shpenzimet për kërkim shkencor dhe zhvillim njihen si shpenzime të njohura me dyfishin e vlerës, për një periudhë 10-vjeçare nga fillimi i veprimtarisë ekonomike.

2. Transferimi i një veprimtarie ekzistuese në territorin shqiptar në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, me qëllim kryesor përfitimin e lehtësive të parashikuara në këtë ligj, është i ndaluar. Çdo transaksion, që në thelb rezulton në transferimin e veprimtarisë ekonomike, sipas përcaktimit të mësipërm, ndalohet.

3. Nëse produktet dalin nga zona për shitje në tregun e brendshëm, me një çmim nën çmimin normal për produktin në fjalë, ose produkte të ngjashme apo të zëvendësueshme në mënyrë direkte, dhe kur i shkaktohet dëm material industrisë vendase, ministria përgjegjëse për ekonominë aplikon një tarifë korrektimi të vlerës së munguar mbi produktin në fjalë. Ministria përgjegjëse për ekonominë ngarkohet për zbatimin e këtij mekanizmi korrektues.

Varianti për Koncesione

Ligji nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar me ligjin nr. 77/2015” dhe aktet neigjore në zbatim të tij

Aktualisht ligji “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” aplikohet në dhënien e koncesioneve nga autoritetet kontraktuese të cilat janë:

- Ministritë e Linjës;
- Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Veprimtaria ekonomike mbi të cilën mund të zbatohen koncesionet/partneritetet publike private janë:

- a) transport (sistemin e hekurudhave, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimin, transportin publik);
- b) prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike dhe energjisë për ngrohje;
- c) prodhim dhe shpërndarje e ujit, trajtim, mbledhje, shpërndarje dhe menaxhim i ujërave të zeza, ujitje, drenazhim, pastrim i kanaleve dhe digave;
- ç) menaxhim i mbeturinave, duke përfshirë mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe depozitimin e tyre;
- d) telekomunikacion; dh) shkencë dhe arsim;
- e) turizëm, argëtim dhe hoteleri;
- ë) kulturë dhe sport;
- f) shëndetësi;
- g) shërbime sociale;
- gj) burgje dhe infrastrukturë gjyqësore;
- h) rehabilitim i tokës dhe pyjeve;
- i) **parqe industriale, miniera** dhe infrastrukturë të ngjashme për mbështetjen e biznesit;
- j) strehim;
- k) godina të administratës publike, teknologji e informacionit dhe infrastrukturë e bazës së të dhënave;

- l) shpërndarje e gazit natyror;
- ll) rehabilitim dhe zhvillim urban dhe suburban.

m) ndriçimi publik ne territorin e njësive administrative vendore dhe ne bujqesi

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrive të linjës apo propozime që këto i marrin nga autoritete të njësive të qeverisjes vendore apo të organeve qendrore të politikës së koncesioneve/partneriteteve publike private, vendos për koncesionet/partneritetet publike private që zbatohen në sektorë të tjerë.

Kompetencat e institucionit:

ATRAKO në zbatim të VKM Nr. 150, datë 22.02.2007, “Per organizimin dhe funksionimin e Agjencise se Trajtimit te Koncesionave”, i ndryshuar, është person juridik publik, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, kjo Agjenci ka kompetencat si më poshtë vijon:

-Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve e ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e rrepublikës së shqipërisë.

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve në bazë të Nenit 12 të Ligjit 125/2013, i ndryshuar me ate 77/2015, kryen këto funksione:

-Bashkerendon me autoritetet kontraktore me qellim:

-a- Pergatitjen e studimit te fizibilitetit

-b- Pergatitjen e dokumentave te procedurës konkurruese dhe kriteret e vlerësimit

-c- Vleresimin e propozimeve dhe përcaktimin e ofertuesit me te mire

-d- Negocimet dhe neshkrimin e kontratës se koncesionit

-e- Monitorimin e kontratave te koncesionit

Njekohesisht kjo Agjensi ndjek sa vijon:

-a-Propozon prane ministrit përgjegjës per ekonominë ndyshimin e legjislacionit ne fushën e koncesioneve si dhe Udhezime ne zbatim e dispozitave te këtij ligji

-b- Monitoron, analizon dhe studion, tendencat aktuale europiane dhe globale te njohurive dhe përvojës ne fushën e koncesioneve/partniriteteve publike, private

-c- Bashkepunon me APP (agjencinë e prokurimit publik) per hartimin dhe publikimin e dokumentave standarte te koncesionit/ partneritetit publik privat.

-11- Te dhëna per marredhenet e pronësisë se tokës, burimet e furnizimit me energji elektrike, uje, etj

Per zgjidhjen e problemit te tokës e cila kërkohet per nje vep[rimtari:

-a- Varianti toke shtet

Aplikanti ne vartësi te nevojave per sipërfaqe toke sipas procedurave, adresohet tek institucionet qe kane te drejtën e vlerësimit te llojit te tokës, kategorinë e saj, etj si dhe ndjek ecurinë deri ne dhënien e sipërfaqes ne administrim qira etj sipas tarifave. Per rastin kur mund te jete pyll apo kullote, përsëri ndiqet procedura e miratimit per dhenin ne përdorim per sa kohe kërkohet te zbatohet projekti, kundrejt disa kërkesave per mjedisin etj

Nder strukturat baze jane edhe ZRPP (Zyra te regjistrimit te pasurisë se palujtshme), strukturat vendore, drejtoritë rajonale te administrimit te tokës etj

Toka mund të jetë :

- Tokë truall e miratuar si zonë ndërtimi

-Toke truall i objekteve ekzistuese industriale

-Tokë bujqësore e pandarë e cila administrohet nga pushteti vendor ku mund të jepet me qira sipas Udhëzimit nr. 1, date 18.07.2012 “Per procedurat e dhënies me qira te tokave bujqësore të pandara”, ndërsa toke bujqësore e ish fermave bujqësore jepet me qira nga Ministria e Bujqesise sipas ligjit nr. 8318, datë 01.04.1998 “Per token bujqësore” i ndryshuar, dhe VKM nr. 460, datë 22.05.2013 në zbatim të këtij ligji.

-Toke e joproductive

-Toke livadhe e kullota

-Shtrate lumenjsh

-Pyje

Per këto raste kemi kete baze ligjore:

-Ligji nr. 9385 , date 04.05.2005 “Per pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar

-VKM nr. 1354, date 10.10.2008 “ Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqien, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor”, ndryshuar me VKM nr. 435, date 08.06.2014.

-VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Per rregullat per paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit tge sipërfaqes dhe te vëllimit te fondit pyjor”, ndryshuar me VKM nr. 434, date 08.06. 2014

-Udhëzimin nr. 1. Date 09.06.2016 te Ministrit te Mjedisit “Per rregullat, procedurat e kërkit, te shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhënie ne përdorim te fondit pyjor e kullosor publik”

-b-Varianti toke private

Negociohet me zotëruesit e tokës per raste kur lindin nevoja qe zona per zhvillim aktiviteti lidhet me prone private, gjithnjë duke siguruar dokumentacionin e duhur nga ZRPP etj qe kjo toke nuk eshte ne administrim e pronësi te shtetit. Pervec kësaj negociohet midis palëve per mënyrën e marrjes se tokës me qira (periudhe afat gjate sipas jetës se projektit) apo akt blerje te noterizuar ne dy variantet.

Te dhëna per infrastrukturën inxhinjerike te zonave ku kërkohet te jepen per zhvillim

-Furnizimi me energji:

Gjendja aktuale e rrjetit e distanca e lidhjes se objektit me zonën

Ne ish objekte industriale si psh Uzina e Rafinimit te Bakrit Rubik dhe Uzina e Telave ne Shkoder, kane infrastrukture pjesore te ngritur si per linje furnizimi me uje dhe energji deri ne hyrje te objekteve ashtu edhe sistemim te ujra kanalizimeve, me ndonjë nevojë per rehabilitim pjesor te tyre.

Ndersa per minierat ekzistuese, rajoni Spaç, Perlat, Derven etj Mirdite, apo te tjera ne rajonin e Korçes, etj lidhjet realizohen ne afërsi te Sistemit te Shperndarjes nga Nenstacionet e zonave respektive, sipas procedurave ligjore

E njëjta gje edhe per ish fabrikën e pasurimit te bakrit ne Rreshen, e cila ka patur linje furnizimi me energji deri ne hyrje te saj

Çmimi aktual per energjinë sipas pikave te lidhjes dhe konsumit etj

E drejta per blerje te saj ne treg

Kuadri rregullues per cilësinë e furnizimit me energji :

Per tarifat e energjisë elektrike eshte Entit Rregullator te Energjise instiducioni ligjor qe varet direkt nga Kuvendi i Shqiperise, i cili merr vendime per tarifat e çmimeve per konsumatorët e energjisë elektrike:

Konkretisht me Vendimin nr. 148, date 26,12.2014 ky ent (ERE) ka miratuar tarifat per 2015, te cilat jane lene ne fuqi përsëri me dy vendime te tjera respektivisht nr. 156, date 24.12.2015 (per vitin 2016) dhe Vendimin nr. 190 date 22.12.2016, te cilat jane ne fuqi deri ne 31 mars 2017.

- **Sipas vendimit të ERE-s Nr. 13, Datë 16.02.2016 “Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t`u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 2016”**

1- Tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t'i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin **2016, do të jetë 7.448 leke/kWh.**

2- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 27 datë 16.02.2015 i Bordit të Komisionerëve të ERE, “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do t'i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet.

3- Diferencat që mund të rezultojnë, ndërmjet çmimit të miratuar për vitin 2016 dhe çmimit të miratuar për periudhën e ndërmjetme me vendimin e Bordit të ERE Nr 156 . datë 24.12.2015, do të sistemohen nëpërmjet korrigjimit të faturimeve përkatëse.

- **Sipas Vendimi nr. 148, datë 26.12.2014** “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”, tarifat e shërbimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike paraqiten si me poshtë:

Tarifat e shërbimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015		
Niveli i tensionit	Cmimi (leke/kWh)	Cmimi pik (leke/kWh)
Konsumatore në 35 k V	9.5	10.93
Konsumatore në 20/10/6 kV	11	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli në 20/10/6 kV	7.1	8.17
Konsumatore në 0,4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0,4 kV	7.6	8.74
Familjare	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndërrim shkallë, pompe,ashensor)	9.5	
Tarife fikse e shërbimit për leximin "zero" (leke/muaj)	200	

**Cmimi i energjisë reaktive është sa 15 % e cmimit të energjisë aktive*

** Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është :*

Per periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00

Per periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23 : 00

- **Me vendimin e ERE-s Nr. 156, Datë 24.12.2015**, këto tarifa janë lënë në fuqi deri në Qershor 2016
- **Me vendimin e ERE-s Nr. 190, Datë 22.12.2016**, këto tarifa janë lënë në fuqi deri në datë 31.03.2017.

- **Me vendimin Nr.128, Datë 29.07.2016** “Mbi tarifat e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientet e lidhur në TM dhe me matës në TU për periudhën 1 korrik -31 dhjetor 2016”, ERE vendosi:
- Për klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU, **të miratojë tarifën 12.4 leke/kWh për shitjen me pakicë të energjisë aktive (jo pik) për periudhën 1 Korrik -31 dhjetor 2016** nga furnizuesi universal. **Me vendimin e ERE-s Nr. 190, Datë 22.12.2016**, kjo tarifë është lënë në fuqi deri në datë 31.03.2017.

Liberalizimi i tregut te energjise elektrike

Ligji Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Neni 109, pika 1 parashikon:

1. *Klientët e energjisë elektrike me tension 110 kV e sipër, si dhe çdo klient tjetër që, pavarësisht nivelit të tensionit të rrjetit të energjisë elektrike, në të cilin është lidhur, ka një konsum vjetor të energjisë elektrike më të madhe se 50 milionë kWh, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohet se kanë dalë në treg të liberalizuar. Klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV janë të detyruar të dalin në tregun e liberalizuar jo më vonë se data 30 qershor 2016, klientët e lidhur në tension 20 kV, jo më vonë se data 31 dhjetor 2016, ndërsa klientët e lidhur në nivelin e tensionit 10 kV dhe 0,6 kV, jo më vonë se data 31 dhjetor 2017. Klientët e lidhur në tension 0,4 kV kanë të drejtë të zgjedhin lirisht furnizuesin e tyre.*

Sipas kalendarit të parashikuar në nenin 109 (Dispozita Kalimtare), të Ligjit Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", ku është parashikuar dalja graduale në treg të liberalizuar për klientët e ndryshëm, sipas nivelit të tensionit dhe konsumit të energjisë elektrike. Aktualisht konsiderohen se kanë dalë në treg të liberalizuar klientët e energjisë elektrike me tension 110 kV e sipër, si dhe çdo klient tjetër që, pavarësisht nivelit të tensionit të rrjetit të energjisë elektrike, në të cilin është lidhur, ka një konsum vjetor të energjisë elektrike më të madh se 50 milionë kWh.

Shoqëria OSHEE sh.a ka filluar investimet në sistemin e matjes për klientët e lidhur me nivelin e tensionit 35 kV, për të mundësuar krijimin e kushteve teknike për daljen në treg të liberalizuar të klientëve të lidhur në nivel tensioni 35 kV.

Furnizimi me uje:

Kuadri rregullator

Baza ligjore ku mbeshtetet dhenia e lejeve/autorizimeve per perdorim burimi uJOR eshte ligji nr.111/2012, date 15.11.2012, "Per menaxhimin e integruar te burimeve uJore" si dhe VKM nr.416, date 13.5.2015, "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve uJore”.

- Aplikimi per leje furnizimi me uje

- Referuar VKM 416/2015, subjekti per marrjen e "lejes per perdorim burimi uJOR" duhet te plotesoje formularin e kushteve te pergjithshme, dokumentacionin tekniko ligjor te parashikuar ne shtojcen I, si dhe te plotesoje formularin A7, te shtojces II, bashke me dokumentet e kerkuara nga ky formular.

Ne raste se veprimtaria kryhet brenda kufijve te nje baseni, organi qe ka kompetence per dhenien e lejes eshte Keshilli i Basenit UJOR ne territorin e te cilit do te ushtrohet veprimtaria.

Per percaktimin e basenit duhet t'i referohet VKM 342/2016 qe percakton kufijte hidrografike te basenve uJore.

Dokumentacioni tekniko ligjor depozitohet prane Agjencise se Basenit UJOR.

- Ne rast se ky subjekt e merr ujin nga nje basen uJOR dhe e ushtron veprimatrine ne nje basen tJeter uJOR ateherë organi kompetent eshte Keshilli Kombetar i Ujit.

Dokumentacioni tekniko ligjor ne kete rast depozitohet prane Sekretariatit Teknik te Keshillit Kombetar te Ujit

-Ne lidhje me tarifat e ujit, duhet ti referohet VKM nr. 662, datë 21.9.2016, "Per miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta"

- Tarifat e përdorimit te ujit lek /m3 uje

Sipas VKM te sipercituar kemi keto tarifa per furnizim me uje dhe shkarkime te lengeta ne uje :

Nr.	Perdoruesi	Tarifat e shkarkimeve te lengeta	Tarifat e perdorimit te ujit		Komente
			Uje siperfaqesor	Uje nentokesor	
1.8	Ndermarrje tregtare e industrial qe perdorin uje per procesin teknologjik ne industri minerare, metalurgji, nafte e gaz, tekstile etj	5 leke/m3	1,5 leke/m3	2,5 leke/m3	

(1 USD = 125 leke)

-12- Problemet mjedisore

Kërkesa per mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës

-a – Per shkarkimet ne toke

-Mbetjet nga shfrytëzimi mineral

Keto mbetje duhet doemos te jene te sistemuara ne venddepozitime te projektuara dhe administruara sipas kërkesave ligjore per te evituar ndikimin ne mjedis.

-Mbetjet nga pasurimi

Keto mbetje duhet te sistemohen ne venddepozitime korekte me standarde e kondicione teknike te tilla qe sigurojnë depozitimin e tyre ne kushte te tilla qe ulin impaktin ne mjedis

Njekohesisht duhet te jene te mbrojtura per te evituar rrjedhjet e saj apo ndonjë plasaritje apo rrëshqitje masive

Kerkesat te tyre jane qe te kontrollohen cilësia e ujrave te shkarkimit ne mjedisin ujqor pritës, ku te arrije normat e përcaktuara ligjore nga pH-i, lënda pezull, si dhe elemente te tjerë te metaleve etj

Kerkesat per projektin e tyre jane rigorozte dhe kalojnë se bashku me projektin e fabrikës se pasurimit per marrjen e lejeve ndertimore dhe atyre te shfrytëzimit.

-Mbetje te tjera industriale nga metalurgjia

Mbetje industriale nga proces te shkrirjes, rafinimit etj si skorje, pluhura te kapura nga sistemi e mbetje qarkulluese, si rregull riperdoren ne proces dhe gjate veprimtarisë, se bashku me projektin e plote te objektit prodhues jane edhe sheshet per depozitime prtovizore apo landfille perfundimtare te tyre.

Legjislacioni shqiptar ka te përcaktuara mënyrën e administrimit te mbetjeve te ngurta sipas natyrës se tyre dhe klasifikimit ne Katalogun e Mbetjeve.

-b- Per shkarkimet ne uje

Ujra siperfaqesore

Norma: (sipas VKM nr. 177, date 31.03. 2005)

-Nxjerrje nga nëntoka apo karriere e mineraleve

pH 6 – 9

Lende e ngurte total 50 mg/litër

BOD5 50 mg/l; COD 150 mg/l; Produkte nafte 10 mg/l ; Cu 0,5 mg/l; Cr 0,1 mg/l;

Ni 0,5 mg/l ; Zn 2 mg/l; Pb 0,2 mg/l; Cianidi total 1 mg/l; Cianid i lire 0,1 mg/l; Hekur 3,5 mg/l; Uranium 2 mg/l; Merkuri 0,01 mg/l; Arsenik 0,1 mg/l

Pasurim (Njelloj si me sipër)

Metalurgjia

Sektori i shkrirjes dhe rafinimit

- pH	6 - 9
- Lende pezull	50 mg/litër
- Arsenik	0,1 mg/l
- Kadmium	0,1 mg/l
- Krom 6 valent	0,1 mg/l
- Krom total	0,5 mg/l
- Plumbi	0,3 mg/l
- Merkuri	0,01 mg/l
- Zinku	1 mg/l
- Hekuri	3,5 mg/l

Derdhje metali

- pH	6 – 9
- Lende pezull	50 mg/litër
- Produkte nafte	10 mg/l
- Bakri	0,5 mg/l
- Zinku	2 mg/l

Per cdo veprimtari subjekti aplikon përpara edhe per paisjen me leje mjedisi. Ne lejen mjedisore jane te përcaktuara kërkesat qe duhet te plotesoje nje subjekt per shkarkimet industriale

Ujra nentokesore (këto jane objekt kontrolli vetëm per Landfille te mbetjeve te pasurimit, dhe atyre te metalurgjisë), ne vartësi te vendndodhjes se tyre etj dhe jane pjese e projekteve per venddepozitimin e tyre.

-c- Per shkarkimet ne ajër

Nga procese teknologjike te përpunimit

-Shkrirje dhe rafinim bakri

Sektori shkrirjes se mineralit dhe koncentrat bakri

Skorja qe del nga procesi i shkrirjes pas ftohejs dhe granulimit me uje,depozitohet dhe riperdoret per material abraziv ne disa sektorë si kantjeret e riparimit te anijeve, tubacioneve te naftës etj. Kjo eksperience ka qene ne zbatim edhe ne Shqiperi ne impiant ne Uzinen e Bakrit ne Rubik dhe nje impiant i instaluar ne Shengjin (porti ne veri te vendit).

Uzina bashkekohore ne bote arrijnë te shkarkojnë jo me shume se 0,5 deri 1 kg/ton bakër metalik te prodhuar dhe $\text{SO}_2 = 25 \text{ kg/ton bakër}$

Si rrjedhoje kërkohet te arrihen ne shkarkimin ne oxhak këto norma:

Pluhuri total ne ajër nga oxhaku = 50 mg/m^3

$\text{SO}_2 = 1000 \text{ mg/m}^3$

$\text{NO}_x = 400 \text{ mg/m}^3$

$\text{CO} = 200 \text{ mg/m}^3$

Per rafinimin me flake te bakrit (prodhim anode)

Ne vartësi te lendes djegëse qe perdoret ose nëse eshte me furre elektrike

-Pluhuri = 50 mg/m^3

- $\text{SO}_2 = 400 \text{ mg/m}^3$

- $\text{NO}_x = 200 \text{ mg/m}^3$

- $\text{CO} = 100 \text{ mg/m}^3$

Kuadri ligjor rregullator per mjedisin:

Ligji nr. 10431, date 09.06.2011, “Per mbrojtjen e Mjedisit”; Ligji nr 10441, date 07.07.2011 “Per vlerësimin e ndikimit ne Mjedis” ; Ligji nr. 162, date 29.12.2014 “Per brojtjen e cilesise se ajrit”; VKM nr. 435, date 12.09.2002 “ Per normat e shkarkimit ne ajër” Etj

-13- Te dhëna per kuadrin rregullator per licensimet dhe rregullimin e territorit

-a-Per paisjen me lejet përkatëse:

-Shfrytezim miniere rregullohet me legjislacionin minerar

-Objekte ndertimore per kantjere pune dhe përpunim minerali etj :

Sipas legjislacionit ne fuqi, (Ligji baze nr. 107, date 31.07.2017 “Per planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” dhe VKM nr. 408, date 13.05.2015 “Per miratimin e rregullores se Zhvillimit te Territorit”, VKM nr. 671, date 29.07.2015 “Per miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit” leja per ndërtimin e objekteve ne miniera, pasurim, metalurgji etj sigurohet nëpërmjet nje procedure te tille:

-a- Subjekti i interesuar kerkon te njihet me Formularin përkatës dhe dokumentacionin e duhur per te marre nje leje ndërtimi per objektet e nevojshme, pranë Agjensise Kombetare te Zhvillimit te Territorit

--b- Paraqet kerkese dhe merr kontakt me organet e pushtetit lokal, ku do te zhvillohet veprimtaria, duke u njogur me planin zhvillimor te zonës i cili eshte miratuar nga qeverisja vendore

-c- Njihet me elemente te pronësisë se tokës ku kërkohet te zhvillohet aktiviteti dhe siguron dokumentacionin e plote

-d- Njihet me infrastrukturën e zonës, rrugët, furnizimin me uje dhe energji, kanalizimet etj

-e- Fillon përgatitjen e dokumentacionit te plote sipas Formularit te dhene nga Agjensia Kombetare e Zhvillimit te Territorit dhe ato specifike qe kërkohen nga pushteti vendor .

Pjese e këtij dokumentacioni jane:

-Dokumentacioni ligjor : (psh kontrate koncesioni etj, Leje shfrytëzimi per miniere, etj Certificate e regjistrimit te shoqërisë ne QKB Qendren Kombetare te Biznesit, Licensat e projektuesve te objekteve.

-Dokumentacion per pronësinë e tokës: Certificate pronësie, me kartelën nga Zyra e Regjistrimit te Pasurive . Nese eshte toke bujqesore veretim nga Drejtoria Administrimit dhe mbrojtjes se Tokes nga Keshilli Qarkut përkatës ku jepen zëra kadastrale boniteti tokës etj

-Pranim kërkesës per shpronësim nga Ministria përkatëse (per rastin e objekteve minerare per shfrytëzim)

-Kontrate per dhënie ne përdorim fondi pyjor ose kullosor

- Vendim nga organet e Basenit rajonal te ujit dhe Keshilli Kombetar i Ujit

Trashegimia Kultureore

-Vertetim i Inst.Monumenteve te Kultures

- Vendim i Keshillit Kombetar te Arkeologjise
- Kontrate me Agjensine e Sherbimit Arkeologjik

Mjedisi

Raport Vleresimi Ndikimi ne M jedis (nga subjekt i licensuar)

- Miratim Vleresimi Ndikimi ne Mjedis Paraprak/Leje Mjedisi etj sipas legjislacionit mjedisor

Pjese e dokumentacionit mjedisor eshte edhe diskutimi paraprak i projektit me publikun ne zonës ku zhvillohet ky projekt. Kjo ndiqet nga subjekti ne bashkërendim me strukturat Mjedisore dhe organet vendore te zonës.

Dokumentacioni Teknik

Harta ku parashikohet veprimtaria dhe objekti e plani vendosjes se strukturës dhe parametrat Urban

Projekti ndërtimor me disa elemente, si Harte e infrastrukturës inxhinierike, imazhe ne tredimesninal 3D te objektit /objekteve, Kordinatat gjeografike, projekt per MNZ

Projekti teknologjik i shoqëruar me Relacion te shkruter

Grafiku i Punimeve dhe plan organizimi per punën ndertimore

Preventiv i realizimit te punimeve

Raporti gjeologo-inxhinierik dhe hidrologjik i zonës

Raport Sizmik per zonën

Oponence teknike (Per ndërtimin) eshte avantazh oponence per projektin teknologjik

Studim fizibiliteti

- Licenca te tjera, per furnizimin me energji tek OSSHE (Operatori Sistemit te Shperndarjes)

-Per furnizimin me uje: Autoritete rajonale te basenit ujëmbledhës per sigurimin e ujit nga lumenj, përrenj apo pus shpime, ndërsa nga Ujesjelles-Kanalizime per uje te pishem nga rrjeti

- Pas dorëzimit te tyre ne Agjencine e Zhvillimit te Territorit, sipas natyrës se projektit, kjo agjensi e dërgon per mendim ne Ministrine përgjegjëse per Minierat dhe Industrine.

Sipas rastit ky projekt mund te kërkohej te mbrohet ne kete dikaster per projektin

-Pastaj dokumentacioni vlerësohet nga Agj.Zhvillimit te Territorit dhe përcillet per miratim ne KKT (Keshillin Kombetar te Territorit)

-Mbrohet projekti ne KKT dhe pastaj del Vendim nga ky organ

-Zbardhje e Lejes se Ndertimit nga Agjencia e Zhvillimit te Territorit.

14- Tatime dhe Taksa:

-Taksa kombetare

- Renta minerare, eshte per bakrin 6 %,
- TVSH, eshte 20 % e vlerës se mallit apo sherbimit
- Tatim fitimi, eshte 15 % e vlerës se fitimit

-Takse vendore

- a- Takse ndikimi ne infrastrukture (ligji per rregullimin e territorit etj)
- b- Takse trualli (sipas Vendimit te organeve bashkiake vendore)
- Takse portuale** -a- Takse depozitimi provizor ne port per nje mall 12 \$/ton

Legjislacioni per taksat dhe tatimet

Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar

Ligji Nr.9975, datë 28.7.2008 “Per taksat kom betarë” i ndryshuar

Ligji Nr. 92/2014 “Per tatimin mbi vlerën e shtuar ne Republiken e Shqiperise”

1 Ky ligj është përafëruar pjesërisht me: Direktivën e Parlamentit European dhe Këshillit 2006/112/KE, datë 28 nëntor

Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar

Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” i ndryshuar

VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “Per dispozitat zbatuese te ligjit nr. 92/2014, “ Per dispozitat mbi vlerën e shtuar ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar

VKM Nr.7, datë 4.1.2012 “Per përcaktimin e procedurave dhe te dokumentacionit te nevojshëm per arkëtimin e taksës se rentës minerare”, i ndryshuar

-15-Mjedisi ne zonat ku parashikohet ky zhvillim :

Pergjithisht kemi te bëjmë me nje zone ku edhe vite me pare ka ekzistuar dhe ka funksionuar kjo industri, realisht me nje tradite dhe dashamirëse ndaj biznesit, rrjedhoje e lidhjes se interesave te tyre me ate te mireperdorimit dhe shfrytëzimit te burimeve natyrore.

Ka nje infrastrukture pjesore ne disa prej objekteve ekzistuese, natyrisht te amortizuara, por qe lehtësojnë kushtet per rehabilitim e përshtatje ne funksion te destinacionit te tyre.

Disponon nje rrjet infrastrukturor dhe rrugor i cili lidhte edhe me rrugët nacionale, natyrisht me disa nevoja per mirëmbajtje.

Ka te trashëguar nje eksperience profesionale, normalisht vetëm ne nje faze fillestare sidoemos ne skemat e përpunimit ne pasurim dhe metalurgji, sepse tashme mosha e tyre eshte disi e thyer, por si faze pergatitore mund te sigurohen profesioniste dhe gradualisht pergatiten te rinj me kurse e trajnime.

Natyrisht se pjese e nje zhvillimi te tille ne këto zona mund te risjellin ne vëmendje edhe hapjen e nje shkolle te mesme profesionale ne nje prej krahinave per miniere, pasurim dhe metalurgji per nje periudhe 10 – 15 vite (nga nje klase me se paku 20 – 30 veta, per sejcilen dege).

Ne eksperiencën e deritanishme zona ku mendohet ky aktivitet nuk ka krijuar problematika deri tani ne lidhje me ecurinë e veprimtarisë ekonomike private.

Nevoja per pune meqenëse ne këto terriore ka shkalle te larte papunësie, rrit akoma me shume shkallen e interesit per te zhvilluar nje veprimtari komplekse industriale.

Ekziston vullneti dhe mbështetja e te zgjedhurve vendore e qendror, duke bashkëpunuar rast pas rasti per zgjidhjen e problematikave qe ndeshen.

II- Kërkesa specifike per ofertuesin:

-1- Eksperienca ne menaxhim te fushës se industrisë minerare dhe përpunuese

-a- Kompani e cila ka nje eksperience ne kete fushe dhe kapitale financiare e njerezore per menaxhim te këtyre pasurive

-b- Te siguroje nje shfrytëzim optimal te vlerave te pasurisë bakërmbajtëse duke realizuar jo vetëm shfrytëzim kompleks te elementeve te dobishëm krahas bakrit edhe arin, argjendin, selenin, e grupin e platinit, si dhe rritjen e asortimenteve te bakrit deri ne tela e kablllo apo edhe prodhimin e lidhjeve te bakrit (tunxh e bronz)

Avantazhe ne vleresim te Ofertes perben subjekti qe merr përsipër te zhvilloje te plote ciklin e përpunimit nga miniera deri ne produkte finale, bakër elektrolitik dhe tela e kablllo.

Ndër kërkesat specifike te nje projekti jane si vijon :

-a- Pasurimi te siguroje shkalle te larte rekuperimi te bakrit mbi 85 % dhe elementeve te tjerë Ari e Argjendi ne koncentrat bakri mbi 40 %.

-b-Te sigurohet përfitim koncentrat zinku nëse ne mineralin e shfrytëzuar, ka përmbajtje optimale zinku,

-c- Te prodhohet edhe koncentrat piriti, si vlere e shtuar ne marrjen e hekurit dhe squfurit qe ka lënda e pare, duke pakësuar edhe mbetjet sterile ne dambe.

-d- Avantazh konkurrues eshte nje projekt optimal ne shkrirje dhe rafinim duke mundësuar riciklimin e mbetjeve metalike si dhe realizuar shfrytëzimin e nxehtësisë se gazeve te proceseve teknologjike, krahas realizimit te pastrimit te gazeve. Si faze e pare ne metalurgji, mund te jete riaktivizimi i Uzines se Rafinimit te Bakrit ne Rubik, vetëm me riciklim te mbetjeve metalike te bakrit, tunxhit dhe bronzit, sepse ka vite qe këto mbetje eksportohen bruto te papërpunuara, me perspektive import te tyre prej vendeve fqinje, Kosova, Mali i Zi. Madje prej ketyre mbetjeve te cilat jane cilësi e pare mund te sigurohet direkt nje sasi produkti katanke bakri, (me shkrirje ne furre elektrike induktive e derdhje te panderprere), qe shërben si lende e pare per tek Uzina e Telave dhe Kablllove ne Shkoder

-2- Mundesia per financime

Kompania e interesuar, te kete mundësi financimi dhe suate te mire ekonomiko-financiare, si një element bindës, për dhënien ne administrim per zhvillim afatgjate te pasurive natyrore e aseteve te tjera te kësaj industrie